



3442
27.26.22.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE
KRIZAVE

Nr. 825/11 Prot.

Elbasan më 15.07. 2022

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.57 datë 30.06.2022 “Për përdorimin e fondit të emergjencave civile”, para se të shprehemi mbi ligjshmërinë e aktit tuaj, kërkojmë të na dërgoni këto të dhëna shtesë:



- Cila është procedura ligjore që është ndjekur nga ana juaj për lidhjen e marrëveshjes së marrjes në përdorim të përkohshëm të mjeteve të personit juridik privat? Bashkëngjisni dokumentacionin provues përkatës.
- Detajoni cilat janë arsyet që keni zgjedhur këtë procedurë.
- A është bërë vlerësimi i nevojës për riparim të mjeteve ekzistuese?
- A është bërë nga ju vlerësimi i nevojës për infrastrukturë, logjistikë shtesë (mjete)? Nëse po a janë marrë masat nga ana juaj që në bazë të vlerësimit të nevojës të parashikohet mundësia e marrjes së mjeteve shtesë duke respektuar afatet dhe procedurat standarde ligjore?
- Gjithashtu përse i përket plotësimit të dokumentacionit tekniko ligjor referuar VKM NR.329 datë 16.05.2012, vihet re mungesa e preventivit të punimeve që do të kryhen miratuar nga Kryetari i Bashkisë.

Deri në dërgimin e të dhënave të kërkuara akti juaj mbetet i pakonfirmuar.

PREFEKTI

Majlinda Perriu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Dt.04.07.2022

Nr. 3147/prot

Nr.57 dt.30.06.2022

“Mbi përdorimin e fondit të Emergjencave Civile”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore “ neni 54 pika dh ,të Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2021“Për Buxhetin e vitit 2022”, në Udhëzimin Nr.2 Datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, udhezimin nr. 9 date 20.03.2018 “ Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit” ,Udhezimi plotesues nr.1 date 10.01.2022 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2022”, V.K.M nr.654 dt.18.12.2002 “Per percaktimin e tarifave per përdorimin e perkohshem nga organet shtetërore, ne situatë emergjente te cdo mjeti privat” ,VKB nr. 101,datë 29.12.2021 “ Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 të Bashkisë Librazhd dhe programit përfundimtar buxhetor afatmesëm 2022-2024” ,“Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 30.06.2022 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1.Të miratojë përdorimin e fondit në vlerën 322,261 leke sipas akt marrëveshjes nr.1917 date 15.04.2022 për gërmim,heqje ,pastrim dhe largim dheu të cilët rrezikojnë banesën e z.Lulzim Alija nga rreshqitja e një masivi dheu dhe guresh.

2.Fondi prej 322,261 lekë do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile miratuar në buxhetin e Bashkisë Librazhd për vitin 2022 .

3.Per sigurimin e këtyre fondeve të miratojë ndryshimin në strukturën buxhetore si më poshtë:

Pakesim në strukturën buxhetore

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	10910	0 1	606	322,261 lekë	Emergjenc Civile

Shtese në strukturën buxhetore

Grupi	titulli	kapitulli	artikulli	vlera	
0 0	10910	0 1	602	322,261 lekë	Emergjenc Civile

gërmim,heqje ,pastrim dhe largim dheu .

4.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

Sek.i Keshillit
Elson Malluta

KRYETARI I KËSHILLIT

Shefki Bahiti

